



Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit

Nr.07/351/01-20683

Dt.05.10.2017

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit duke vendosur sipas kërkesës së parashtruar nga: **Fatos (Esat) Maloku** nga Gjakova, për dhënien e Lejes së Ndërtimit për ndërtimin e objektit të kategorisë së dytë, me destinim – objekt banimor shumë banesor, etazhiteti i objektit është B+P+4+KSH, në bazë të Ligjit për Ndërtim, Nr. 04/L-110, nenet 14, 15, 19, 20 dhe 21, si dhe Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-031 nenit 21, 44 dhe 97, bien këtë:

AKTVENDIM

I. I LEJOHET: Fatos (Esat) Maloku nga Gjakova, ndërtimi i objektit të kategorisë së dytë, me destinim – objekt banimor shumë banesor, Sipas Projektit Kryesor të prezantuar, në përputhshmëri me Planin Rregullues Urban të zonës “Jugu 2”, në ngastrën kadastrale me nr. 5106/45, ZK: Gjakovë –J- Qytet, në pronësi të lartëpërmendurit, në rrugën “Hysni Dobruna”, e cila ka vijën e ndërtimit dhe rregullimit të definuar dhe të prezantuar në planin e situacionit me të gjithë parametrat tjerë përcjellës për ndërtimin e objektit në fjalë, etazhiteti i objektit është B+P+4+KSH, me sipërfaqe të përgjithshme (bruto) të objektit $S=1421.39 \text{ m}^2$

Bodrumi:	(Sip.Bruto):		$S=200.92 \text{ m}^2$
Përdhesa:	(Sip,Bruto):		$S=172.92 \text{ m}^2$
Kati i parë:	(Sip,Bruto):		$S=220.45 \text{ m}^2$
Kati i dytë:	(Sip,Bruto):		$S=220.45 \text{ m}^2$
Kati i tretë:	(Sip,Bruto):		$S=220.45 \text{ m}^2$
Kati i katërt:	(Sip,Bruto):		$S=220.45 \text{ m}^2$
Kulmi i shfrytëzueshëm:	(Sip,Bruto):		$S=220.45 \text{ m}^2$



II. Hartimin e projektit me destinim: ndërtimi i objektit të kategorisë së dytë, me destinim – objekt banimor shumë banesor, nga pika 1 e këtij aktvendimi e ka bërë ndërmarrja për konsultim, projektim, ndërtim, supervizim dhe rekonstrukcion “Conip RK” - Gjakovë.

III. Pjesë përbërëse e këtij aktvendimi është Plan Situacioni i lokacionit me objektin sipas vijës së ndërtimit dhe rregullimit, e përshkruar në situacionin grafik për të cilin është dhënë pëlqimi përkatës nga kjo drejtori i cili është bazë për rilevimin gjeodezik të objektit nga pika 1 e këtij aktvendimi.

IV. Investitori është i obliguar:

- Që të ruaj një ekzemplar origjinal të dokumentacionit teknik në bazë të cilit i është dhënë kjo Leje Ndërtimi;
- Që pa pëlqimin e hartuesit të projektit kryesor dhe pëlqimin e kësaj Drejtorie, të mos bëjë asnjë ndryshim në projekt;
- Ekzekutimi i punimeve nga pika 1 e këtij Aktvendimi, të realizohet nën mbikëqyrjen e organit mbikëqyrës për realizimin e ndërtimit të objektit.
- Të lajmëroj Drejtorinë e inspektionit për ditën e fillimit të punës së paku 8(tetë) ditë para fillimit të ndërtimit, me qëllim të verifikimit dhe përcjelljes së punimeve;

V. Kjo Leje Ndërtimi vlen 1(një) vit nga dita e lëshimit të këtij aktvendimi.

Arsyetim

Fatos (Esat) Maloku nga Gjakova, me banim në rrugën “Hysni Dobruna”, ka parashtruar kërkesën pranë DUMM me nr. 07/351/01-20683, dt. 02.10.2017, për dhënien e Lejes së Ndërtimit, për ndërtimin e objektit të kategorisë së dytë, me destinim – objekt banimor shumë banesor, me etazhitet të objektit B+P+4+KSH, në ngastrën kadastrale ndërtimore me nr. 5106/45, ZK: Gjakovë –J- Qytet, në rrugën “Hysni Dobruna” siç është përshkruar në pikën 1 të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Së bashku me kërkesën investitori e ka prezantuar edhe këtë dokumentacion:

1. Planin e Situacionit në përpjesë 1:500, të datës 09.06.2017, i punuar nga “GEO-REJ”SHPK-Gjakovë.
2. Kopjet planit të datës 19.07.2017, në pronësi të Fatos (Esat) Maloku, të lëshuar nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
3. Certifikatën mbi të drejtën në pronën e paluajtshme (fotokopje) me nr. të lëndës 1035/17, të datës 04.07.2017, të lëshuar nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
4. Kushtet Ndërtimore, me nr. 07-351/01 - 14722 të datës 25.07.2017, për rregullimin e hapësirës për ndërtimin e objektit të banimit individual, në ngastrën kadastrale me nr. 5106/45, ZK: Gjakovë –J- Qytet, të lëshuar nga DUMM.
5. Raporti mbi kërkimet gjeomekanike në teren si dhe kërkimet laboratorike në lokacionin e parashikuar për ndërtimin e objektit afaristo banesor, me Investitor Fatos Maloku nga Gjakova, në ngastrën kadastrale me nr. 5016/45, të hartuar nga “Geomerkur” Sh.p.k.Gjakovë.
6. Lejen Mjedisore Komunale me nr. 07-351/1 - 19181, dt.22.09.2017, lëshuar nga DUMM.
7. Pëlqimin për lokacion nga mbrojtje kundër zjarrit, me nr.210/17 me datë 25.09.2017, lëshuar nga Axhencia e Menaxhimit Emergjent, Departament i Parandalimit, Ministria e Punëve të Brendshme.
8. Vërtetimin mbi kryerjen e obligimeve nga tatimi në pronë, nr 430-L-52 të datës 22.06.2017.
9. Pëlqimin nga KEDS-Gjakovë, me nr.1539, dt. 22.09.2017.
10. Pëlqimin nga K.R.U.”Radoniqi”Sh.A.-Gjakovë, me nr.2308, dt.04.08.2017.
11. Pëlqimin nga PTK- Sh.A. Gjakovë, të datës 27.07.2017.
12. Dëshminë mbi kryerjen e obligimeve nga taksa administrative dhe tarifa rregullative për rritjen e densitetit në BKT, filiali në Gjakovë, të datës 02.10.2017.
13. Projektin kryesor në 3 (tri) kopje, i punuar nga ndërmarrja për konsultim, projektim, ndërtim, supervizim dhe rekonstrukcion “Conip RK” - Gjakovë.

Taksa administrative dhe tarifa rregullative për rritjen e densitetit është paguar në vlerën prej 5780.08 Euro.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij Aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 30 ditësh, duke u llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim. Ankesa i parashtrohet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Prishtinë, dhe e njëjta dorëzohet nëpërmjet kësaj Drejtorie.

Aktvendimi i dorëzohet:

- Investitorit,
- Drejtorisë së Inspektionit,
- Arkivit.

Zyrtar i Lartë për Çështje Juridike

Zenel Shabani, jur. i dipl.

U. D. Drejtori

Elida Bejtullahu, inxh. e dipl. e ark.




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor /Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja/Ministry of Environment and Spatial Planning
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT \ KOPIJA PLANA \ COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija \ Municipal Cadastral Office : GJAKOVË
Zona Kadastrale / Katastarska Zona \ Cadastral Zone : Gjakovë J. Qytet

Njësia \ Jedinica \ Unit	Tipi \ Vrsta \ Type	Sipërfaqja \ Poveršina \ Area m ²
P - 70705028 - 05106 - 45	Parcelë \ Parcela \ Parcel - oborr	255.0
	Parcelë \ Parcela \ Parcel - objekt - ndërtesë	141.0



Shkalla / Razmera /Scale: 1:500

Punoi \ Obradio \ Created :
Data \ Data \ Date : 19.07.2017
Koha \ Vreme \ Time : 14:42:17
Nënshkrimi \ Potpis \ Signature:
Shënim \ Beleška \ Note :

Aprovoi \ Usvojio \ Aproved : Drejtori \ Direktor \ Director




Nënshkrimi \ Potpis \ Signature:

K.K. GJAKOVË

Zona kadastrale : Gjakove Jashte Qytet

Parcela nr.5106-46

PLAN SITUACIONI



P = 1 : 500

Punoi : Driton Shllaku, gjeodet i licencuar



Punoi : "GEO-REJ" SH.P.K.
DREJTORI